

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 671 Rep.

NR. 340 Kol.

KONTRATE SHITESË KONCESIONI

PER

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NE KONTRATEN E KONCESIONIT TE FORMES
"BOT" TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE "EURON"
SH.P.K., "KADRIA" SH.P.K., "TEUTA KONSTRUKSION" SH.P.K. PER NDERTIMIN
E HIDROCENTRALEVE "ORGJOSTI RI", "BELE 1", "BELE2", "TOPOJAN 1" DHE
"TOPOJAN 2"

Në Tiranë, më datë 14 muaji 11, viti 2014 (dymijë e katërbëdhjetë), para meje noter
Ar Blushi anëtar i dhomës së Noterisë TIRANË me adresë
Rogovë, 11, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar nga znj. Etleva Kondi, e datëlindjes 29.03.1972, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga ID 028001010

DHE

Shoqëria koncesionare "Euron Energy Group" sh.p.k. me seli ne Kukes, ne adrese: lagja nr.6, pallati nr.8, Ap 7/1, e perfaqesuar nga administratori i saj Z. Gëzim CELA, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftim ID 030367006 .

Palët të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë kontrate shtese konçesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Konçesionit të formës "BOT", të nënshkruar nga palët Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Koncesionarit, Bashkimi i Perkohshem i Shoqerive "EURON" sh.p.k., "KADRIA" sh.p.k., "TEUTA KONSTRUKSION" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve "ORGJIST I RI", "BELE 1", "BELE 2", "TOPOJAN 1" dhe "TOPOJAN 2" datë 17.11.2008, me Nr. 9203 Rep., Nr. 1038 Kol., miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1581, datë 03.12.2008.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

Qeveria e Shqipërisë

Synon aplikimin e strategjive afatgjata dhe efikase për sistemin elektro-energjetik të Shqipërisë, me qëllim krijimin e një Sistemi Elektroenergjetik të qëndrueshëm operacionalisht, teknikisht dhe financiarisht, të aftë për të plotësuar kërkesën në rritje për energji elektrike brenda vendit duke e shndërruar Shqipërinë nga vend importues i energjisë elektrike, në vend eksportues të saj.

Si dhe:

- Kërkesës që shoqëria koncesionare “Euron Energy Group” Sh.P.K., me ane të shkresës nr.3644/2, datë 24.07.2014, ka depozituar pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, “Për aprovimin e ndarjes së Koncesionarit “Euron Energy Group” sh.p.k në tre operatore (shoqëri pritëse)
- Relacionit “vlerësim investimi” të AKBN-së, për HEC-et “Orgjost i Ri”, “Bele 1”, “Bele 2”, “Topojan 1” dhe “Topojan 2” të përcjellë në MEI me shkresën nr.7517/1prot., dt.24.09.2013 nga ku rezulton se: *shoqëria koncesionare “Euron Energy Group” sh.p.k., ka përfunduar punimet ndërtimore sipas standardeve të ndërtimit për ndërtimin e HEC-eve në datë 31 Dhjetor 2013 dhe është në fillimet e fazës së prodhimit të energjisë elektrike. Treguesit ekonomike janë realizuar në masën 126% krahasuar me vlerën e investimit sipas nenit 9 të kontratës së koncesionit.*
- *Projekt zbatimin e HEC-eve “Orgjost i Ri”, “Bele 1”, “Bele2”, Topojan 1” dhe “Topojan 2” te miratuar nga METE me shkresën nr.4030/3prot., dt.28.05.2009.*
- Përfundimit të investimit sipas përcaktimit të paragrafit të fundit të nenit 9 të kontratës koncesionare në përputhje me programin e punimeve të përcaktuar në nenin 10 (pika 10.2., afat i cili është ndryshuar me shkresën nr. 640/6 date 10.6.2011 dhe pengesat e krijuara nga CEZ Shpendarje sh.a. e cila ka vonuar Dhenien e Tensionit të Linjes TL me rreth 8 muaj si dhe vonesa e krijuar nga Emergjenca Lokale për shkak të rreshjeve të mëdha të bores dhe temperaturave tepër të ulta në periudhën 3 shkurt 2012 – 1 Mars 2012)
- *Nenit 8 të kontratës së koncesionit dhe konkretisht “detyrimet e koncesionarit, pika 1 ku ndër të tjera cilësohet se:... Shoqëria e krijuar do të nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri”, pra posaçërisht ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*
- Vendimit të Asamblesë së Ortakëve nr.1, datë 24.07.2014 në të cilën është vendosur miratimi i Projekt-Marrëveshjes së Ndarjes së shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. duke shpërndarë aktivet dhe pasivet e saj në tre shoqëri pritëse: shoqëria pritëse e parë “Alb-Energy” shpk që do të fitoj 47.16% të aksioneve të shoqërisë “Euron Energy

Group” shpk; shoqëria pritëse e dytë “Euron Energy” shpk që do të fitojë 36,58% të aksioneve të shoqërisë “Euron Energy Group” shpk dhe shoqëria pritëse e tretë “Energal” shpk që do të fitojë 16.26% të aksioneve të shoqërisë “Euron Energy Group” shpk

- Ligji nr.9901, dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ku në Titullin 2 “Ndarja”, neni 227 “Përkufizimi, dispozitat e zbatueshme” në pikat 1, 2 dhe 3 përkatësisht cilësohet se: *1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të asamblesë së përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur. 2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të këtij ligji. 3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet e kësaj të fundit*
- Shkresës së Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, nr. 640/6 date 10.6.2011 drejtuar Koncesionarit “Miratohet kërkesa për shtyrje afati”, që ka të bëjë me zbatimin e VKM nr. 448, date 16.6.2010 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 27, date 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 873 date 13.12.2010 “Për përcaktimin e kriterëve për shtyrjen e afateve të përgatitjes së projekteve të zbatimit dhe marrjes së lejeve në kontratat koncesionare të miratuara” me anë të së cilës është dhënë miratimi i Autoritetit Kontraktues, për shtyrjen e afateve të ndërtimit të hidrocentraleve me 24 muaj;
- Shkresës së shoqërisë koncesionare “Euron Energy Group” sh.p.k. nr. 3644/9 date 4.11.2014 “Sqarime lidhur me Relacionin vlerësim investimi për Hec-et “Orgjost i ri, Bele 1, Bele 2, Topojan 1 dhe Topojan 2” si dhe me shkresën e AKBN-së lidhur me Përllogaritjen e Penaliteteve”, ku midis të tjerash, janë përmbledhur të gjithë problematikat që ka hasur shoqëria koncesionare për vënien në punë të hidrocentraleve. Pengese për testimin e me pas për vënien në punë të hidrocentraleve ka qenë shoqëria CEZ Shpendarje sh.a. e cila ka vonuar Dhënien e Tensionit të Linjës TL me rreth 8 muaj. Gjithashtu ka pasur Emergjenca Lokale nga reshjet e mëdha të bores dhe temperatura tepër e ultë në periudhën 3 shkurt 2012 – 1 Mars 2012;

Ministria e Energjisë dhe Industrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me qëllim rritjen e efektivitetit në administrimin e hidrocentraleve të ndërtuar tashmë, për ndarjen e përgjegjësi në mënyra sa më të përshtatshme, për rritjen e produktivitetit pasi një strukturë e vogël manovrohet më lehtë si dhe për rritjen e efikasitetit në mirëmbajtjen e hidrocentraleve dhe optimizimin e produktivitetit të tyre, menaxhimin sa më të mirë të burimeve kapitale dhe njerëzore të shoqërisë, e ka gjykuar si të arsyeshme aprovimin e ndarjes së koncesionarit “Euron Energy Group” sh.p.k. në tre operatorë (shoqëri pritëse) : “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k.

Për këtë arsye,

Palët bien dakord që në Kontratën baze të Konçesionit të formës B.O.T. "Për ndërtimin e hidrocentraleve "ORGJIST I RI","BELE 1", "BELE 2", "TOPOJAN 1" dhe "TOPOJAN 2" , të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në Kontratën baze të Konçesionit të formës B.O.T. "Për ndërtimin e hidrocentraleve "ORGJOST I RI","BELE 1", "BELE 2", "TOPOJAN 1" dhe "TOPOJAN 2" kudo ku është shprehur termi Autoritet Kontraktues dhe Koncesionar, këto terma do të kenë kuptimin përkatës si me poshtë vijon:

1. Autoritet kontraktues është Ministria e Energjisë dhe Industrisë

2. Koncesionar për hidrocentralet: "Bele 2" dhe "Topojan 1" (me karakteristikat e Hidrocentralit sipas percaktimit ne nenin 3 te kontrates se koncesionit) do te jete shoqëria "ALB-ENERGY" shpk

Shoqëria "Alb-Energy" shpk me seli ne Tirane ne adrese:Rr Asim Vokshi Nd 14, H 4, Ap 6, Njësia Bashkiake 9, Kodi Postar 1016, Tirane Shqipëri , e përfaqësuar nga administratori i saj Z. Pëllumb Beta.

Shoqëria pritëse "Alb-Energy" shpk themeluar ne përputhje me ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe kapitalin si me sipër e ka përfituar nga ndarja e shoqërisë Euron Energy Group.

Shoqëria pritëse "Alb-Energy" shpk ka si objekt te veprimtarisë se saje: Ndërtimin, administrimin, operimin, shfrytëzimin, transferimin e hidrocentraleve. Marrjen përsipër te detyrimeve dhe te drejtave qe rrjedhin nga kontrata koncesioni, tregtimin e energjisë elektrike si edhe çdo lloji veprimtarie kryesore apo dytësore qe lidhen me fushën e energjisë elektrike

3. Koncesionar për hidrocentralin: " Orgjost i Ri", (me karakteristikat e Hidrocentralit sipas percaktimit ne nenin 3 te kontrates se koncesionit) do te jete shoqëria "ENERGAL" sh.p.k.

Shoqëria "ENERGAL" shpk me seli ne Tirane ne adrese: Rruga Shyqyri Brari, Pallati EURON 3, pranë Liqenit Artificial, Tirane, Shqipëri , e përfaqësuar nga administratori i saj Z. Avni DOMI.

Shoqëria pritëse "ENERGAL" shpk themeluar ne përputhje me ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe kapitalin si me sipër e ka përfituar nga ndarja e shoqërisë Euron Energy Group .

Shoqëria pritëse "ENERGAL" shpk ka si objekt te veprimtarise se saje: Ndërtimin, administrimin, operimin, shfrytëzimin, transferimin e hidrocentraleve. Marrjen përsipër te detyrimeve dhe te drejtave qe rrjedhin nga kontrata koncesioni, tregtimin e energjisë elektrike si edhe çdo lloji veprimtarie kryesore apo dytësore qe lidhen me fushën e energjisë elektrike

4. **Koncesionar për hidrocentralet: "Bele 1" dhe "Topojani 2"** (me karakteristikat e Hidrocentralit sipas përcaktimit në nenin 3 të kontratës së koncesionit), do të jetë shoqëria **"EURON ENERGY" sh.p.k**

Shoqëria **"EURON ENERGY" shpk** me seli në Tiranë në adresë: Rruga Shyqyri Brari, Pallati EURON 3, pranë Liqenit Artificial, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori i saj Z. Gëzim CELA.

Shoqëria pritëse **"EURON ENERGY" shpk** themeluar në përputhje me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe kapitalin si me sipër e ka përfituar nga ndarja e shoqërisë Euron Energy Group.

Shoqëria pritëse **"EURON ENERGY" shpk** ka si objekt të veprimtarisë së saj: Ndërtimin, administrimin, operimin, shfrytëzimin, transferimin e hidrocentraleve. Marrjen përsipër të detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kontrata koncesioni, tregtimin e energjisë elektrike si edhe çdo lloji veprimtarie kryesore apo dytësore që lidhen me fushën e energjisë elektrike.

Neni 2

Në kreun III "Të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit", në pikën 2 të nenit 10 "Programi i punimeve", fjalët *".....brenda 23 (njëzetetë) muajve nga hyrja në fuqi e Kontratës Koncesionare, sipas aneksit 2 bashkëlidhur"* zëvendësohet me *".....brenda 56(pesëdhjetëgjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës koncesionare"*

Neni 3

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, shoqëritë pritëse të përcaktuara në nenin 1 të kësaj Kontrate, do të nënshkruajnë Marrëveshje të veçanta në cilësinë e Koncesionarit me Autoritetin Kontraktues duke respektuar detyrimet dhe të drejtat në fuqi të përcaktuara në Kontratën Koncesionare.

Kjo kontratë shtesë, hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet" i ndryshuar.

Kjo marrëveshje u hartua në 4 (katër) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lire e të plotë, dhe unë notere e vërtetoj atë rregullisht.

AUTORITETI KONTRAKTUES

MINISTRIA E ENERJISE DHE INDUSTRISE

Zj. Etleva KONDI

KONCESIONARI

"EURON ENERGY GROUP" sh.p.k.

Z. Gëzim CELA



